

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: K.K. SKENDERAJ

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr ¹ i prokurimit	643-25-2953-5-1-1
Nr i brendshëm	022

Sa i përket tenderit për: Ndertimi i Kolektorit Llaushë-Tushilë-Aqarevë në Komunën e Skenderajt

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit *

DIAMANTI SH.P.K

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. "Naim Frashëri" Nr-16

(Adresa)

Prishtinë

10000

(Vendi)

(Kodi postar)

+38344776839

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Azem Tahiraj

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

shpkdiamanti@gmail.com

(Adresa elektronike)

22.05.2025

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe yula)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- 1.Njoftimi për Kontratë : **14.04.2025**
 - 2.Data e planifikuar e hapjes së ofertave: **23.05.2025**
 - 3.Kërkesa për rishqyrtim:**13.05.2025**
 - 4.Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim:**15.05.2025**

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

☐

Jo

☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet



A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

☒

Jo

☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

☒

Jo

☐

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 27 i LPP-së
Neni 28 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së
Neni 19 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik
Neni 26 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik

**** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.**

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.



Pas një shqyrtimi të detajuar të dokumentacionit të paraqitur, kemi vënë re se AK-ja ka përfshirë kërkesa aspak te logjikshme, mekanizem i cili është i panevojshëm për ekzekutimin e projekti, favorizuese/diskriminuese duke eliminuar konkurrencën.

Me këtë kërkesë, te panevojshme, jo profesionale dhe aspak te logjikshme po ju njoftojmë se nuk mund të ketë trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik, përndryshe do të ketë diskriminim të hapur dhe përcaktim të fituesit qysh në start të këtij aktiviteti të prokurimit, andaj këtë kërkesë e cila AK-ja ka përshtatur një OE të caktuar, ku ka kërkuar llojin e mekanizmit të cilin e posedon vetëm një kompani në rajon dhe (Kosovë), mekanizem i cili është i panevojshëm për ekzekutimin e projektit dhe njeherit me vetedije të plot po e demton taksën e qytetarve, perkatsisht dëmtimin e buxhetit të Komunes Skenderaj dhe Shtetit.

Në momentin që përshtaten kërkesat atëherë OE i cili i plotëson këto kërkesa do të ofertojë me çmim shumë më të lartë, ashtu siç ka ndodhur në shumë raste.

Pretendimi nr.1

- Konkretisht, në dokumentet e tenderit, është përcaktuar si kërkesë që operatorët ekonomikë të disponojnë:

- *Makine për shpime horizontale nëntokesore me sistem të kontrollit laser.DN110-550mm cope 1*
- *Makine për shpime horizontale nëntokesore me sistem të kontrollit laser.DN550-1220mm cope 1*

- a. Kërkesa që makina të jetë me **sistem të kontrollit me laser** është e panevojshme dhe absurde, pasi absolutisht nuk ka nevojë për një makinë të tillë. Shpimet horizontale mund të realizohen edhe me makina **pa sistem të kontrollit me laser** nga operatorë ekonomikë me përvojë të gjerë në fushën e shpimeve horizontale nëntokësore, madje me saktësi maksimale, ashtu siç është theksuar edhe nga Autoriteti Kontraktues në vendimin për rishqyrtimin e kërkesës.
- b. Kërkesa që të jenë **dy makina** me dimensionet e specifikuar – njëra **DN110-550 mm** dhe tjetra **DN550-1220 mm** – është favorizuese dhe shkon në drejtim të përfitimit të një kompanie të vetme. Ju njoftojmë se, sipas informatave që posedojmë, në tregun e Kosovës dhe rajonit vetëm kompania **Union Raketa** ka në dispozicion makina me sistem të kontrollit me laser, çka e bën këtë kërkesë diskriminuese dhe jolegjitime. Kjo kompani **ka monopol** për këtë lloj makine dhe **nuk bën marrëveshje për shfrytëzimin** e pajisjes përveç me një operator ekonomik të caktuar, për të cilin duket se është formuluar edhe vetë kërkesa. Prandaj, kërkesa për **sistem të kontrollit me laser** dhe për dy makina me dimensione të caktuara duhet të largohet.
- c. Nga cilido këndvështrim që të analizohet, kjo kërkesë e Autoritetit Kontraktues, e formuluar në këtë mënyrë, është diskriminuese për shumicën **absolute të operatorëve ekonomikë në Republikën e Kosovës** dhe favorizon në mënyrë të qartë vetëm një operator të caktuar ekonomik – konkretisht kompaninë Union Raketa. **Në këtë mënyrë, është e dukshme se është përcaktuar që në fillim fituesi i këtij tenderi.**
- d. Prandaj, për të siguruar një proces të mirëfilltë të prokurimit, me kritere të drejta dhe ligjore, është e domosdoshme të largohet kërkesa që makina për shpime horizontale të **ketë sistem të kontrollit me laser**, si dhe të hiqet kërkesa për **dy copë makina**, e cila është po ashtu e panevojshme. Projekti mund të ekzekutohet në mënyrë të suksesshme edhe me një makinë për shpime horizontale nëntokësore, **pa sistem kontrolli me laser.**

Ju informojmë gjithashtu se deri më tani janë bërë **tri kërkesa për rishqyrtim** nga operatorë ekonomikë për largimin e kësaj kërkesë diskriminuese.

Gjithashtu AK-ja shkel LPP duke mos shtyre afatin prej 10 dite të Hapjes së Tenderit nga Vendimi për rishqyrtimin e kërkesës.



Prandaj për të pasur një aktivitet të mirëfilltë të prokurimit dhe me kritere korrekte e ligjore, ju duhet të largoni këto kërkesa nga DT.

Me këto kërkesa nuk mundësohet pjesëmarrje e gjerë e operatorëve ekonomik, por në këtë mënyrë është kufizuar tej mase konkurrenca dhe këto kërkesa janë drejtpërdrejtë jo në harmoni me çmimin dhe lëndën e prokurimit, sepse kur kufizohet konkurrenca me kërkesa të pa nevojshme atëherë edhe çmimi ofertues i operatorëve ekonomik të favorizuar automatikisht është shumë më i lartë, ndërsa kjo ndodh për shkak se nuk kanë konkurrencë dhe faktikisht determinohet çmimi nga ana e autoritetit kontraktues në bazë të kërkesave të dosjes së tenderit dhe pothuajse është pashmangshme demtimi i buxhetit.

Me keto kërkesa që tani dihet fituesi i këtij tenderi dhe pastaj mundësia është shumë e madhe e dëmtimit të buxhetit sepse kompania që e plotëson këtë kërkesë normalisht që oferton me çmim më të shtrenjtë.

Këto kërkesa bien ndesh plotësisht me nenin 7 të LPP-së përkatësisht paragrafët 1, 2, 3 dhe 6. Paragrafi 1 i nenit 7 parasheh qartë që *“Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente”*.

Me këto kërkesa, jo që nuk mund të ketë trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik por do të ketë diskriminim të hapur dhe përcaktim të fituesit qysh në start të këtij aktiviteti të prokurimit, pa konkurrencë të hapur dhe natyrisht që mundësia e dëmtimit të buxhetit është shumë e madhe.

Paragrafi 6 i dispozitës së nenit 7 parasheh qartë : *Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit”*.

Me këto kërkesa nuk mundësohet pjesëmarrje e gjerë e operatorëve ekonomik, por në këtë mënyrë është kufizuar tej mase konkurrenca dhe këto kërkesa janë drejtpërdrejtë jo në harmoni me çmimin dhe lëndën e prokurimit, sepse kur kufizohet konkurrenca me kërkesa të pa nevojshme atëherë edhe çmimi ofertues i operatorëve ekonomik të favorizuar automatikisht është shumë më i lartë, ndërsa kjo ndodh për shkak se nuk kanë konkurrencë dhe faktikisht determinohet çmimi nga ana e autoritetit kontraktues në bazë të kërkesave të dosjes së tenderit.

Ju në këtë rast me këto kërkesa, nuk e keni pasur parasysh nenin 26.4 të Rregullave dhe Udhëzuesit operativ për prokurim publik, sepse aty shkruan qartë se *“Gjatë përcaktimit të kërkesave minimale për kualifikim, AK do të kushtoj rëndësi të veçantë zhvillimit të OE dhe do të formuloj kërkesat minimale të kualifikimit në mënyrë që nuk përjashton OE të themeluar rishtazi të cilët posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme ekonomike, financiare dhe/ose teknike”*. Pra jo vetëm që po ju pamundësoni ofertimin operatorëve ekonomik të themeluar rishtazi në kundërshtim me nenin e lartcekur, por po ju pamundësoni ofertimin edhe OE me përvojë të madhe në këtë fushë.

Duke u bazuar në të gjitha këto kërkesa diskriminuese-favorizues dhe në dëshmitë e kërkuara, rezulton se në këtë mënyrë nuk mund të arrihet qëllimi këtij aktiviteti të prokurimit dhe qëllimi i LPP-së, siç parashihet në nenin 1 të këtij ligji, e ku shkruan qartë: *Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.*

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe kundërshtimet tona që u cekën më lartë, rezulton se ju si autoritet kontraktues nuk e keni përpiluar dosjen e tenderit në harmoni me nenin 27 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk e keni pasur parasysh as nenin 18.9 të RRUOPP ku shkruan qartë që *“Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë që nuk: Kufizon konkurrencën në mesin e OE, ose Diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose më shumë OE-ve.*



Prandaj të gjitha kërkesat të cilat i kontestuar më lartë duhet larguar/ndryshuar për të pasur një aktivitet të prokurimit normal dhe për të mos u diskriminuar/favorizuar kompanitë e caktuara.

Gjithashtu pa dashur që këtë paralajmërim ta keqkuptoni, ju njoftojmë se këtë tender me këto kërkesa dhe dëshmi të kërkuara ne e konsiderojmë tender **të kurdisur** dhe normalisht që nëse nuk ndryshohen kërkesat do të jemi të detyruar të bëjmë denoncime edhe në organet tjera të cilat i përkasin fushës penale.

Duke u bazuar në faktet që u përmenden më lartë, kërkojmë nga OSHP që të nxjerr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE **“Diamanti SH.P.K”**- Prishtinë.

NDRYSHOHEN kërkesat, që u cekën më lartë dhe pastaj të veprohet konform nenit 53.7 të LPP-së

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore institucionet tjera kompetente.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, në vlerë prej 10,000.000 euro.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.

